

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TE PËRGJITHSHËM TE PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

1. Përcaktime

- 1.1** Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Sigurimin Përgjegjësive Profesionale, këtu e në vazhdim do të quhen **“Kushtet e sigurimit”**.
- 1.2** Shoqëria e sigurimeve, këtu e ne vazhdim do të quhet **“Siguruesi”**.
- 1.3** Personi fizik dhe/ose juridik, subjekt i kësaj kontrate sigurimi, i cili ka paguar primin e sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet **“I Siguruari”**.
- 1.4** Dokumenti që provon dhe rregullon kontratën e sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet **“Polica e sigurimit”**.
- 1.5** Shuma e maksimale e përgjegjësië së Siguruesit e përcaktuar në policën e sigurimit, këtu e ne vazhdim do të quhet **“Limiti i përgjegjësive”**
- 1.6** Shuma e mjeteve monetare që i paguhet Siguruesit, për lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e ne vazhdim do të quhet **“Primi i Sigurimit”**.
- 1.7** Shuma maksimale që Siguruesi merr përsipër të paguajë me ndodhjen e ngjarjes së sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet **“Shuma e Dëmshpërblimit”**.
- 1.8** Dëmi i shkaktuar Palëve të Treta brenda periudhës së sigurimit, që rrjedhin nga çdo kërkesë:
- **qe është bërë për herë të parë ndaj të siguruarit gjatë periudhës së sigurimit; dhe**
 - **i njoftohet Siguruesit gjatë Periudhës së Sigurimit; dhe**
 - **lind nga një veprim ose mosveprim të kryer pas datës retroaktive, në qoftë se një datë prapavepruese është specifikuar në policën e sigurimit**
- që vinë si rezultat i neglizhencës, gabimeve apo mangësive në kryerjen e shërbimeve profesionale nga i siguruari në kundërshtim me rregullat dhe praktikat e njohura në përgjithësi për profesionin, si dhe - shpenzimet e mbrotjes ligjore të kryera me miratim paraprak me shkrim të Siguruesit në lidhje me kërkesat për dëmshpërblim ndaj të Siguarit, do të quhen **“Ngjarja e sigurimit”**.
- 1.9** Veprimet, mosveprimet, shkeljet, gabimet dhe pakujdesitë gjatë kryerjes së punës të përfaqësuesit të të Siguarit apo të punonjësve të autorizuar prej tij dhe që i sjellin si pasojë dëm Palëve të Treta do të quhen **“Përgjegjësi profesionale në punë”**.

2 Njoftimet e të Siguarit

- 2.1** Deklarimet e të Siguarit duhet të jenë të sakta dhe të plota.
- 2.2** Në rast të ndodhjes së ngjarjes së sigurimit i Siguruari duhet t'i lejojë Siguruesit të inspektojë çdo material, dokumentacion që ka në lidhje me të Siguarin dhe demin e ndodhur.
- 2.3** Kur pas lidhjes së kontratës së sigurimit del se i Siguruari, me dijeni, ka dhënë informata jo të sakta në kërkesën ose në dokumentat e paraqitura dhe në bazë të të cilave është lidhur kontrata e sigurimit, Siguruesi ka të drejte:
- 2.3.1** Të kundërshtojë vlefshmërinë e kontratës brenda 3 muajve nga dita qe ka marre dijeni për pasaktësinë e deklarimeve ose lënien në heshtje të tyre, duke kërkuar ndryshimin e kushteve të saj në prim, afatin e sigurimit ose në shumën e sigurimit;
- 2.3.2** Të zgjidhë kontratën e sigurimit në rast se ka rrethana të tilla që po ti dinte Siguruesi nuk do të kishte lidhur kontratën;
- 2.3.3** Kur ngjarja e sigurimit ka ndodhur, të refuzojë pagimin e dëmshpërblimit në çdo rrethanë.
- 2.3.4** Primet e sigurimit të paguara deri në kohën e zgjidhjes së kontratës së sigurimit, nuk i kthehen të Siguarit.
- 2.4** Dëmi duhet të ketë ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin dhe/ose ligjeve në fuqi, duhet të jetë kryer nga përfaqësuesi i të siguarit dhe/ose nga punonjës të tij në ushtrim të detyrave dhe kryerjen e punës të kontraktuar.

3. Hyrja në fuqi e sigurimit

Sigurimi hyn në fuqi në orën 24.00 të ditës së përcaktuar në Policën e sigurimit pasi:

- 3.1.1** Është arkëtuar primi ose kësti i parë i primit të sigurimit;
- 3.1.2** Polica e sigurimit është lëshuar nga Siguruesi dhe nënshkruar nga i Siguruari;

3.2 Në qoftë se Polica e Sigurimit parashikon një datë fillimi të mëvonshme, sigurimi do të hyjë në fuqi në orën 24.00 të ditës së caktuar.

4 Përfitimi i Dëmshpërblimit

4.1.1 Siguruesi merr përsipër të paguajë:

- shumat për të cilat i Siguruari është ligjërisht përgjegjës të paguajë si kompensim dëmi kundrejt palës së dëmtuar dhe shpenzime të tjera që rezultojnë nga ngjarja e sigurimit për të cilën është e zbatueshme kjo policë sigurimi brenda kufijve të përgjegjësishë;
- shpenzimet e mbrojtjes ligjore të kryera me miratim paraprak me shkrim të Siguruesit në lidhje me kërkesat për dëmshpërblim ndaj të Siguararit;

kur plotësohen këto kushte:

- Dëmi duhet të ketë ardhur si rezultat i shkeljes së rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin dhe/ose ligjeve në fuqi;
- Dëmi duhet të jetë kryer nga përfaqësuesi i të siguararit dhe/ose nga punonjës të tij në ushtrim të detyrave dhe kryerjen e punës të kontraktuar sipas kontratës së punës ose shërbimit.
- Ngjarja e sigurimit duhet të ketë ndodhur përpara përfundimit të policës së sigurimit.
- I Siguruari dhe/ose punonjësit e tij kanë kryer të gjitha veprimet dhe kanë përdorur të gjitha mundësitë e tyre për minimizimin e dëmit të ndodhur ku përfshihet edhe njoftimi i organeve të specializuara për minimizimin e këtyre dëmeve.

4.1.2 Deme ne Seri-Disa kërkesa për dëmshpërblim që përfshijnë një të siguar që janë ngritur gjatë vlefshmerisë së kësaj Kontrate dhe që rrjedhin nga i njëjti shkak apo ngjarje, për shembull nga i njëjti gabim ndertimi, prodhimi apo instruksioni ose nga dorezimi i produkteve të tilla të cilat kanë të njëjtat defekte, do të konsiderohen të jene një “ngjarje demesh ne seri”, panvaresisht kur humbjet kanë ndodhur faktikisht, dhe ato humbje do të konsiderohen të kene ndodhur ne te njejten kohe me humbjen e pare te aplikueshme qe rrjedh nga e njejti shkak apo ngjarje.

5 Primi i Sigurimit

5.1 Primet e sigurimit duhet të paguhen në kohën e caktuar në marrëveshje, pranë zyrave të Siguruesit ose në llogarinë e tij.

5.2 Mospagimi në vazhdim i kësteve të primit sipas afateve të caktuara, në rast se është përcaktuar që primi të paguhet me këste, sjell pezullimin e sigurimit nga ora 24 e ditës së pesëmbëdhjetë pas mbarimit të afatit të pagimit.

5.3 Pas kalimit të afatit 15 ditor, Siguruesi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe primet e paguara i mbeten Siguruesit.

5.4 I Siguruari nuk çlirohet nga detyrimi për pagimin e primit edhe nëse pretendon se Siguruesi nuk i ka njoftuar afatet e skadencës.

6 Rreziqe të Përjashtuara

6.1 Ky sigurim nuk mbulon ngjarjen e sigurimit të shkaktuar nga:

6.1.1 lufta, invazioni, lufta me një shtet tjetër (e shpallur ose jo), lufta civile, rebelimi, grushtet e shtetit, turbullirat civile, revolucionit ose ngjarje të tjera të kësaj natyre;

6.1.2 Terrorizmi

6.1.3 jonizimi, rrezatimi, kontaminimi radioaktiv i shkaktuar nga lëndë djegëse ose mbeturina nukleare, eksplozione radioaktive toksike ose armë të tjera eksplozive të rrezikshme;

6.1.4 shpërthimet vullkanike, tërmetet, zhvendosjet e tokës dhe përmblytjet;

6.1.5 përdorimi i lendeve eksplozive dhe korozeve, përveç rasteve kur është në përmbushje të detyrës profesionale;

6.1.6 aktet kriminale dhe veprimet e dhunshme nga persona me të cilët i Siguruari ka konflikte të mëparshme, ose pjesëmarrja e trashëgimtarëve ligjore, ortakeve ose përfituesit në akte që passjellin ndodhjen e rastit të sigurimit;

6.2 Përgjegjësia profesionale në punë që ka ndodhur përpara hyrjes në fuqi të kësaj police.

6.3 Dëmet e ardhura si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të qëllimshme apo të pandershme të të Siguararit, ngjarje që i Siguruari i priste të ndodhnin ose kishte të gjitha kushtet të parashikonte se do të ndodhnin duke ditur natyrën dhe rrethanat e këtyre veprimeve ose mosveprimeve.

6.4 Dëmet nga gjobat, penalitetet, masat korrektuese që nuk lidhen me këtë policë sigurimi.

- 6.5 Kërkesat për dëmshpërblim që kanë lidhje me vonesat në zbatimin e detyrimeve dhe kompensimet në lidhje me zbatimin e kontratave të të Siguruarit.
- 6.6 Pandershmeria e punonjesve
- 6.7 Vjedhja ose shpifja
- 6.8 Çdo akt i qëllimshëm, i pandershëm dhe me qëllim të keq i Siguruesit ose punonjësve të tij.
- 6.9 Çdo neglizhim, gabim ose mosveprim nga ana e të siguruarit në mbajtjen e tij të sigurimit.
- 6.10 Çdo neglizhim, gabim ose mosveprim në lidhje me shërbimet dhe aktivitetet e kryera që shkojnë përtej fushëveprimit të shërbimeve përkatëse profesionale sipas legjislacionit të brendshëm, kodeve etike dhe rregullave
- 6.11 Paaftësi pagueuse / Falimentimi i te siguruarit.
- 6.12 Humbjet e pastra financiare
- 6.13 Rreziku përfshirë USA / Kanada legjislacionin.
- 6.14 Përgjegjesia e produktit
- 6.15 Çdo neglizhim, gabim ose mosveprim nga ana e të siguruarit në kushtet e konfliktit të interesit.
- 6.16 Këshillimi apo auditimi për të njëjtin klient.

7 Përfundimi i Kontratës së Sigurimit

Kontrata e sigurimit do të konsiderohet e përfunduar në rast se ndodh një nga ngjarjet e mëposhtme:

- 7.1 Kontrata e punës është ekzekutuar plotësisht;
- 7.2 Ka mbaruar periudha e sigurimit;
- 7.3 Ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe Siguruesi ka paguar dëmshpërblimin deri në limitin e përgjegjësive;
- 7.4 Primet nuk janë paguar brenda 15 ditëve nga lindja e detyrimit.

8 Çedimi, Pengu dhe Bllokimi

I Siguruarit në këtë kontratë sigurimi nuk mund ta çedojë kontratën tek të tjerët, ta japë peng ose të bllokojë shumat e sigurimit.

9 Lëshimi i Dublikatës

Nëse Polica origjinale priset, griset ose dëmtohet në çdo lloj tjetër mënyre duke u bërë e palexueshme, I Siguruarit duhet të pajiset me një Police të re sigurimi.

10 Ngjarja e sigurimit

- 10.1 Me vërtetimin e ngjarjes së Sigurimit dhe/ose marrjes së kërkesës për dëmshpërblim, i Siguruarit detyrohet të njoftojë Siguruesin brenda një afati 48 orë duke specifikuar rrethanat e ngjarjes dhe pasojat e tij, si dhe të zbatojë porositë e dhëna nga Siguruesi.
- 10.2 Asnjë pranim i përgjegjësive, premtim për oferte, apo pagese nuk duhet bërë pa miratimin me shkrim të Siguruesit. Siguruesi do të ketë të drejtën të marrë përsipër dhe të kryejë në emër të të siguruarit mbrotjen, ose pagesën e çdo dëmi që rezulton nga ngjarja e siguruar dhe të ndjekë në rrugë ligjore kërkesat për kompensim nga persona të tjerë, shkaktarë të demit. I Siguruarit duhet të japë të gjithë informacionin dhe asistencën që i kërkohet nga Siguruesi.
- 10.3 Për të gjitha pagesat e dëmshpërblimit që do të bëjë Siguruesi, duhet të dorëzohen paraprakisht, sipas rastit këto dokumenta:
 - 10.3.1 Kërkesa për dëmshpërblim së bashku me Policën Origjinale të Sigurimit;
 - 10.3.2 Dokumentat që vërtetojnë shumën e dëmshpërblimit që Siguruesi detyrohet të paguajë;
 - 10.3.3 Kallëzimin e bërë në organet e prokurorisë (nëse zbatohet);
 - 10.3.4 Çdo dokument tjetër plotësues të kërkuar nga Siguruesi, në varësi të rastit.
- 10.4 Dokumentacioni i plotë i dorëzohet Siguruesit brenda 30 ditëve nga data e ngjarjes së sigurimit. Shpenzimet për grumbullimin dhe dërgimin e dokumentacionit janë në ngarkim të të Siguruarit.
- 10.5 Siguruesi duhet të fillojë pagimin e dëmshpërblimit që rrjedh nga kjo kontratë sigurimi, brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të dokumentacionit të plotë.
- 10.6 Pagesat do të bëhen në monedhën e treguar në Policën e Sigurimit, në llogarinë e te Siguruarit.

11 Dispozita të tjera

Kjo kontratë dhe marrëdhënia mes palëve do të zbatohet dhe interpretohet sipas ligjeve shqiptare në fuqi. Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo kontratë, nëse nuk zgjidhen me mirëkuptim, do të zgjidhen në rrugë gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

12 Dispozita të fundit

12.1 Klauzola e përjashtimit të sulmeve kibernetike

Pavarësisht dispozitave të përmbajtjes së ndryshme brenda këtij sigurimi ose çdo miratimi pranohet që ky sigurim përjashton përgjegjesine nga sulmet kibernetike, i cili nënkupton çdo rrezik të humbjes financiare, ndërprerjes ose dëmtimit të reputacionit të një organizate nga një lloj dështimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit. ky sigurim ne asnje rast nuk mbulon humbje, demtime, përgjegjesi apo shpenzime te shkaktuara ose te ndikuara direct ose indirect qe rrjedhin nga perdorimi si mjet per te shkaktuar dem i cdo kompjuteri, sistemi kompjuterik, programi soft kompjuterash, kode keqdashesh, virusesh kompjuterike ose cdo sistemi tjeter apo paisje tjeter elektronike.

12.2 Klauzola e përjashtimit te semundjeve ngjitese

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të ofrojë mbulim dhe Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim për çdo dem që lidhet me dëme trupore (përfshirë Stresin Emocional ose traumën mendore ose fobinë), çdo lloj demesh ose humbjes materiale, të cilat janë ose pretendohet të jenë shkaktuar nga, të ndikuara nga ose në çdo mënyrë të lidhura me:

Sindromën e fituar të imunitetit të ulur (SIDA/AIDS) ose agjentëve patologjik të tij ose hepatiti;

Semundjet ngjitëse: Me semundje ngjitëse do të kuptohet çdo semundje, e cila mund të transmetohet midis njerëzve, kafshëve ose bimëve, ose me anë të ndonjë substancë ose agjenti nga ndonjë organizëm në një organizëm tjetër, kur:

- substancë ose agjenti përfshin, por nuk kufizohet vetëm në një virus, bakter, parazit ose organizëm tjetër ose ndonjë ndryshim të tij, qoftë ai që konsiderohet i gjallë ose jo, dhe - metoda e transmetimit, qoftë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, përfshin por nuk është e kufizuar në, transmetimin në ajër, transmetimin e lëngjeve trupore, transmetimin nga ose në ndonjë sipërfaqe ose objekt, të ngurtë, të lëngshëm ose gaz ose midis organizmave, dhe
- sëmundja, substancë ose agjenti mund të shkaktojë ose kërcënojë dëmtimin e shëndetit të njeriut ose të mirëqenies njerëzore ose mund të shkaktojë ose kërcënojë dëm, përkeqësim, humbje të vlerës së, tregtueshmërinë ose humbjen e përdorimit të pasurisë

12.3 Klauzola e Sanksioneve

Pavarësisht parashikimeve në këtë Policë Sigurimi, Siguruesi nuk do të jetë i detyruar të paguajë ndonjë kërkesë për dëmshpërblim ose të japë ndonjë përfitim sipas kësaj kontrate, nëse ofrimi i një mbulimi të tillë, pagesa e një kërkesë të tillë ose dhënia e një përfitimi të tillë do të ekspozonte Siguruesin ndaj ndonjë sanksioni, ndalimi ose kufizimi, sipas Rezolutave të Kombeve të Bashkuara ose sanksioneve tregtare ose ekonomike, ligjeve ose rregulloreve të Bashkimit Europian, gjithashtu sipas Ligjit Shqiptar, Mbretërisë së Bashkuar ose Shteteve të Bashkuara të Amerikës.